



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”  
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE  
KOLEGJI DOKTORAL**

**PROCEDURA E KONKURIMIT**

Konkurimi do të kalojë nëpër tri faza

• **FAZA 1**

**VLERËSIMI I DOKUMENTACIONIT PËR APLIKIM**

Këtu vlerësohen kualifikimet dhe dokumentacioni I dorëzuar nga kandidatët. Pikët maksimale janë 50, të ndarë si më poshtë:

- nota mesatare mbi 8 (10 pikë)
- Projekti kërkimor i paraqitur (20 pikë)
- publikime të mëparshme (10 pikë)
- vlerësimi i përmbledhjes së temës së masterit (5 pikë)
- eksperiencë në mësimdhënie (5 pikë)

Brenda datës **22.02.2023** në ambientet e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, afishohet lista e studentëve fitues për këtë fazë.

• **FAZA 2**

**PROVIMI ME SHKRIM**

Pikët maksimale janë 25.

Testi kalohet me minimumi 10 pikë. Testi konsiston në zhvillimin me shkrim të një tematike të caktuar nga Kolegji Doktorale. Temat publikohen bashkë me shpalljen e konkurrimit.

Provimi me shkrim, do të zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, në datë 24.02.2023, ora 10.00-12.00, salla 202 godina C (Telemedicina).

• **FAZA 3**

**PROVIMI ME GOJË**

Pikët maksimale janë 25.

Provimi me gojë konsiston në një prezantim të detajuar të projektit të kërkimit, të prezantuar nga kandidati si edhe certifikimin e njohurive në gjuhë të huaj.

Provimi me gojë do të zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, në datë 28.02.2023, ora 10.00-14.00, salla 202 godina C (Telemedicina).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”  
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE  
KOLEGJI DOKTORAL**

*Pas përfundimit të tri fazave, Kolegji Doktoral, shpall brenda datës 03.03.2023 listën e me renditjen e plotë të aplikantëve sipas pikëzimit. Kandidatët që kanë marrë me shumë pikë, kualifikohen (sipas kuotave të miratuara, 10(dhjetë) kandidatë). Aplikanti mund të njihet mbi vlerësimin e tij, nëpërmejt kërkesës drejtuar Kolegjit Doktoral, mbi vlerësimin e aplikimit të tij. Aplikanti merr përgjigje me shkrim, brenda 10 ditëve nga momenti i depozitimit të kërkesës.*